

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Driton Muharremi kryetar, Have Haliti dhe Mejreme Memaj, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.L. nga Mitrovica, G.H. nga fsh. ..., Komuna e Prishtinës, M.H. nga fsh. ..., Komuna e Istogut dhe E.L. nga fsh. ..., Komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje edhe me të akuzuarin B.I. i cili gjendet në arrati, shtytje në kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, i akuzuari F.M. nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale ndihmë në shtytje për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Speciale të R. së Kosovës dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve: B.L., av. A.K., G.H., av. A.H., M.H., av. B.T., E.L., av. S.J. dhe F.M., av. B.Ç., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.162/2017 datë 19.07.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara, ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve B.L., G.H., M.H., E.L., dhe F.M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.162/2017 i datës 19.07.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë DKR, PKR.nr.162/2017 të datës 19.07.2017 të akuzuarit: B.L., G.H., M.H. dhe E.L. janë shpallur fajtor për veprat penale në bashkëkryerje edhe me të akuzuarin B.I. i cili gjendet në arrati se kanë kryer veprën penale shtytje në kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, dhe janë dënuar, i akuzuari B.L. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e gjashtë (6) gjashtë muaj, i akuzuari G.H. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e gjashtë (6) gjashtë muaj, i akuzuari M.H. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e gjashtë (6) gjashtë muaj, i akuzuari E.L. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e gjashtë (6) gjashtë muaj, i akuzuari F.M., për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale shtytje për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite.

Koha e kaluar në paraburgim të gjithë të akuzuarve iu llogaritet nga data 11.07.2015, e tutje.

Të akuzuarit janë obliguar që shpenzimet e procedurës gjyqësore t'i paguajnë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj secili veç e

veç shumë prej nga 50 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarve iu ka vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak shkeljeve të ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit të shpallen fajtor për veprën penale në bashkëkryerje edhe me të akuzuarin B.I. i cili gjendet në arrati, përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër Rendit Kushtetues dhe Sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 dhe me nenin 145 dhe 135 par.1 nënpar 1.7 të KPRK-së, i akuzuari F.M., për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale të Terrorizmit nga neni 137 par.2 lidhur me nenin 388 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarve : B.L., G.H., M.H., E.L. dhe F.M., t’iu shqiptohet dënim më i lartë me burgim.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.L. av. A.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal, për shkak të vërtetimit dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe të akuzuarin ta lirojë nga akuza apo ta anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje si dhe ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.H. av. A.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit Penal dhe vendimit për dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovojë në terësi ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta anulojë, të mbrojturin e tij ta lirojë nga aktakuza ose çështjen ta kthejë në rigjykim.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.H. av. B.T., për shkak të shkeljes së Ligjit Penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë dhe aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe vendim, si dhe ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.L., av. S.J., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta lirojë nga akuza ose çështjen të kthejë në rigjykim, gjithashtu, ka paraqitur edhe përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës, me propozim që ankesa të refuzohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M. av. B.Q., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së Ligjit Penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa në tersi dhe çështjen ta kthejë në rigjykim ose vendim ose ta ndryshojë aktgjykimin në dobi të akuzuarit dhe të akuzuarin ta shpall të pafajshëm.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/L.nr.415/17 datë 18.09.2017, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit B.L., G.H., M.H. dhe E.L. të

shpallen fajtorë për vepër penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe Sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.4 lidhur me nenin 145 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse të akuzuarin F.M., ta shpallë fajtor për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale terrorizmit nga neni 137 par. 2 lidhur me nenin 388 par. 12 të KPRK-së, si dhe t'iu shqiptohet dënim më i lartë me burgim, ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve dhe përgjigja në ankesën PSRK të refuzohen si të pa bazuara.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK, u mbajt seanca e kolegjit të kësaj gjykate në të cilën morën pjesë të akuzuarit B.L., G.H., M.H., E.L. dhe F.M., mbrojtësit e tyre avokatët A.K., A.H., B.T., S.J. dhe av. B.Q.. Në seancë nuk mori pjesë Prokurori i Apelit edhe pse i njoftuar me rregull.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e PSRK-së, si dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve si dhe shkresat tjera të lëndës dhe në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se:

Ankesa e PSRK-së, dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, janë të pa bazuara.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.L. av. A.K., pretendon se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyet e aktgjykimit në raport me të mbrojturin e sajë, nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, ndërsa ato që janë paraqitura janë plotësisht të paqarta dhe kundërthënëse dhe jo të sakta. Gjykata nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Nuk ka bërë vlerësimin e saktësisë së provave kundërthënëse dhe nuk ka cekur arsyet e mosmiratimit të propozimeve konkrete të palëve. Gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e ka bazuar në deklaratën e të bashkë të akuzuarit B.L., për të cilin është veçuar procedura dhe i njëjti është marrë në pyetje nga policia me autorizimin e prokurorit, kurse mbrojtjes i është mohuar e drejta e parashtrimit të pyetjeve, me çka është shkelur parimi procedural që palëve t'iu mundësohet pozita juridike e barabartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.H. av. A.H., në ankesë pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë, është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, se dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyetimin dhe faktet në bazë të cilave është nxjerrë ky aktgjykim, në raport me veprën penale shtytje në kryerjen e veprave penale terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së. Mbrojtja konsideron se shtytja është element i bashkëveprimit, e si është e mundur që në të njëjtën vepër penale të ekzistojnë elementi i shtytjes dhe elementi i bashkëkryerjes, ngase këto dy elemente nuk mund të qëndrojnë së bashku, por duhet sqaruar se a ka vepruar dikush si shtytës, apo si bashkëkryerës. Për të ekzistuar shtytja duhet sqaruar se ndaj kujt është drejtuar shtytja e caktuar, se a mund të merret si shtytje në qoftë se ka pasur të lexohet një letër e kontestuar, se përmbajtja e asaj letrë nuk ka pasur të bëjë me kurrfarë ftese përkryerjen e veprave terroriste dhe nuk ka rezultuar me shkaktimin e rrezikut.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.H. av. B.T., po ashtu, pretendon se aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se gjykata detyrohet t'iu vërtetojë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm si dhe t'iu vërtetojë faktet kundër të akuzuarit si dhe në favor të tij, të vlerësojë çdo provë një nga një dhe të nxjerr përfundim nëse një fakt konkret është provuar. Dëshmia e dëshmitarit M.V. dhe J.P. nuk kanë ofruar ndonjë provë, e cila vërteton veprimet inkriminuese të mbrojturit të tij.

Mbrojtësja e të akuzuarit E.L. av. S.J., pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, se aktgjykimi nuk përmban faktet vendimtare, i mbrojturi i sajë nuk ka të bëjë asgjë me veprën penale për të cilën është akuzuar. Prokuroria nuk ka paraqit fakte me të cilat dëshmohet, se i mbrojturi i sajë e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e ka bazuar në deklaratën e B.I., i cili gjendet në arrati si bashkë akuzuar, edhe përkundër insistimit të mbrojtjes se kjo provë të shpallet si e papranueshme, me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i saj e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M. av. B.Ç., pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë, është i bazuar në prova të pa pranueshme, se akuzuari ka punuar si taksist, natën kritike të akuzuarit G. dhe B. , të cilët i ka njohur edhe më herët, i ka dërguar në destinacionin ku ata kanë kërkuar, kurse nuk e kanë bërë pagesën sepse nuk kanë pasur të holla. Gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur me asnjë provë të vërtetojë fajësinë e të akuzuarit, se i akuzuari gjatë gjithë procedurës ka deklarua se nuk e ka ditur qëllimin e të bashkakuzuarve, por i kanë thënë se kanë shkuar për ta falur namazin e natës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i ankimuar është i çartë dhe i kuptueshëm, në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi të gjitha faktet vendimtare, kurse faktet vendimtare janë vërtetuar drejtë dhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë, aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë, e as që ka shkelje tjera esenciale të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e që kishin me ndikuar në anulimin e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit është përpiluar sipas dispozitave të neni 365 par. 1 nën par 1.1 të KPPK-së, ku janë shënuar faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varët zbatimi i dispozitave përkatëse. Se në aktgjykimin e ankimuar nuk ka kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit, kjo për arsye se gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, ka dhënë arsyet e mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale të akuzuarve, e që vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarëve M.V. dhe J.P., si dhe nga provat materiale, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes dhe foto dokumentacioni nga Njësia e forenzikes datë 11.07.2017, raporti dhe foto dokumentacioni i Krim Teknikës Kriminalistike i datës 11.07.2015, fotoalbumi mbi ekzaminimin e veturës Golf, letra e shkruar në alfabetin latin në gjuhën arabe, CD me incizimet e kamerës se sigurisë së objektit E-Petrol të datës 10.07.2015 mbi marrjen me qira të veturës Passat, si dhe dëshmi të tjera të administruara nga gjykata e shkallës së parë, e që janë në shkresat e lëndës, të cilat janë elaboruar në detale në aktgjykimin e ankimuar dhe kanë paraqitur të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Kjo gjykata i ka shqyrtuar me kujdes dhe vëmendje aktgjykimin e shkallës së parë, dhe ka konstatuar se pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale janë të pa bazuara.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.L. av. A.K., në ankesë pretendon, se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, se gjykata e shkallës së parë, me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se i mbrojturi i saj ka ndërmarrë veprime lidhur me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, se vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë, janë të pa qëndrueshme e që deri te ky vërtetim i gabuar ka ardhur si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, i mbrojturi i sajë është takuar me shokët e tij për iftar dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të inkriminuar në veprën penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.H., av. A.H. pretendon se me provat e administruara gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, se deklarata e bashkë të akuzuarit B.B., nuk ka mund të lexohet në shqyrtim kryesor ngase, është veçuar procedura, e që me te është dashur të veçohen edhe deklaratat e tij të dhëna më herët në fazat e procedurës paraprake. Se sendet e gjetura të Liqeni i Badovcit, e të cekura në raportin e shikimit të vendit të ngjarjes nuk janë marrë nga i akuzuari G.H., se edhe ekzaminimi i bërë e përjashton të mbrojturin e tij si kontribues në këtë çështje penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.H., av. B.T., e konteston vërtetimin e gjendjes faktike duke theksuar se provat e administruara nuk kanë mbështetje në gjendjen faktike, dëshmitë e dëshmitarëve M.V. dhe J.P., nuk kanë ofruar ndonjë provë që vërteton veprimet inkriminuese, për më tepër dëshmia e dëshmitarit M.V. nuk ka kredibilitet të provës pasi që sipas informatave që i ka mbrojtja, ndaj të njëjtit janë të iniciuara më shumë se 20 raste të vjedhjes së automjeteve të cilat kanë qenë të parkuara në Liqenin e Badovcit, e konteston fotoalbumin që gjendet në dosje të lëndës pasi që fotot e evidentuara janë të vitit 2010-2012 që nuk korrespondojnë me çështjen penale me të cilën i akuzuari dyshohet, pasi që në këtë kohë nuk ka ekzistuar organizata e shpallur terroriste si “ISIS” dhe “Al Nusra” dhe se këto aktivitete të akuzuarit nuk mund të atribuohen si vepra penale për të cilat është shpall fajtor. Gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e ka bazuar në supozime e sidomos kjo vërehet kur gjen se “nuk përjashtohet mundësia edhe e ngrënies së syfyrit para leximit të B.it nga se para se të arrinin te vendi i ngjarjes M. me të hollat që ja kishte dhënë B.i ka blerë 5 hamburger, ndërsa e vërteta qëndron me atë se numri i hamburgerëve të blerë nga M. përputhet me numrin e saktë të personave me të cilët u takua në vendin e ngjarjes. I mbrojturi i tij gjatë gjithë fazave të procedurës ka deklaruar njëjtë, se nuk ka pasur fare njohuri për qëllimin e shkuarjes te Liqeni i Badovcit rrethanë kjo që vërtetohet edhe nga i bashkakuzuari B.I.. Nuk ka pasur marrëveshje paraprake pasi që M.H. prej të akuzuarve e njeh vetëm B.I. dhe B.L., nuk ka prova se ka ekzistuar një marrëveshje e tillë, i mbrojturi i tij ma tepër është një viktimë, idetë e të cilëve kanë qenë të pa kjarta, se në rastin konkret në bazë të provave të administruara më tepër kemi të bëjmë me heqjen dorë në mënyrë vullnetare nga kryerja e veprës penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit E.L. av. S.J., thekson se aktgjykimi është i përfshirë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka vlerësuar provat lidhur me ekzistimin apo mos ekzistimin e fakteve vendimtare për marrjen e aktgjykimit. Nuk është vërtetuar se i mbrojturi i sajë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe se prokuroria nuk ka paraqitur fakte lidhur me këtë çështje. Janë dëgjuar dëshmitarët dhe të akuzuarit dhe se asnjëri prej dëshmitarëve nuk ka theksuar se i mbrojturi i sajë ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M. av. B.Q., thekson se aktgjykimi i shkallës së parë, është i përfshirë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që gabimisht është vërtetuar, se shërbimi që i mbrojturi i tij në cilësinë e taksistit i ka bërë të akuzuarve tjerë nuk ka qenë ndihmë në kryerjen e veprave penale terroriste, kjo për faktin se posa kanë hipur në veturë i ka pyetur se për çka kanë qenë te Liqeni i Badovcit në orët e vona, të akuzuarit iu kanë përgjigjur se kanë qenë për ta falur namazin e natës dhe për të ngrënë syfyrin dhe ky nuk ka pasur dyshim se ata kanë qenë për ndonjë qëllim tjetër. Ka qenë bashkëpunues me policinë, prokurorinë dhe gjykatën duke theksuar se është besimtar mysliman i devotshëm dhe se gjithë besimtarët mysliman i ka vëllëzër e cila deklaratë kuptohet gabimisht duke u marr si provë nga gjykata për ta dënuar për veprën penale të cilën në asnjë formë nuk e ka kryer.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve lidhur me gjendjen faktike, gjykata e shkallës së parë, drejtë i ka vlerësuar, se nga shkresat e lëndës, dëgjimit të akuzuarve dhe provave tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se të akuzuarit B.L., G.H., M.H. dhe E.L., në bashkëkryerje edhe me të akuzuarin B.I. i cili gjendet në arrati, më dt. 10.07.2015, rreth orës 23,30min, në afërsi të liqenit të Badovcit, me qëllim që të shpërndajnë apo të publikojnë mesazhe për publikun, me anë të rrjetit social, kanë tentuar të dërgojnë mesazhe, me qëllim që të shtyjnë personat të pa përcaktuar që të kryerjen vepra terroriste, duke e përdorur ikonografinë e organizatës terroriste ISIS (flamuri i ISIS-it), kanë dashur ta inçizojnë videon propaganduese, të cilët më parë ishin pajisur me pushkë automatike A-47 me bajonetë, 5 karikatorë dhe 32 fishekë, si dhe me uniforma ushtarake, maska për fytyrë, dorëza dhe flamurin e organizatës terroriste të ISIS-it, me leximin e B.it të letrës ndaj udhëheqësit të organizatës terroriste ISIS, Abu Baker-al Bagdati dhe ta publikojnë këtë video në internet për ta dëshmuar shtrirjen e ISIS në Republikën e Kosovës, për të shpërndarë këtë mesazh për publikun me qëllim të nxitjes në terrorizëm të cilin nuk kanë arritur ta publikojnë për shkak të arrestimit nga ana e policisë, të akuzuarit janë vërejtur nga roja e sigurimit të liqenit të diga e Liqenit të Badovcit, ku në vendin e ngjarjes janë arrestuar të akuzuarit B.L., E.L. dhe M.H., ndërsa të akuzuarit G.H. dhe B.I., janë arratisur nga vendi i ngjarjes, me ndihmën e të akuzuarit F.M..

Ndërsa, i akuzuari F.M., me qëllim të dhënies së ndihmës kryerësve në kryerjen e veprës penale, më dt.11.07.2015, rreth orës 2,00 të mëngjesit, ka shkuar te liqeni i Badovcit, sipas ftesës së të akuzuarit G.H., i ka transportuar të akuzuarin G.H. deri në ..., ndërsa të akuzuarin B.I., i cili gjendet në arrati, deri në shtëpinë e tij në Istog, se i njëjti më parë e ka ditur qëllimin e të akuzuarve, se përse janë mbledhur tek liqeni i Badovcit, iu ka mundësuar të njëjtëve largimin nga vendi i ngjarjes dhe nga arrestimi i policisë.

Gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar të gjitha provat, konform dispozitave të nenit 361 par. 2 të KPPK-së, pas vlerësimit të tyre ka nxjerrë konkludim të drejtë duke bërë ricilësimin e veprës penale për të akuzuarit B.L., G.H., M.H. dhe E.L., në veprën penale në bashkëkryerje shtytje në kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, kurse për të akuzuarin F.M., ndihmë në kryerjen e veprës penale shtytje për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së, se qëllimi i të akuzuarve ka qenë incizimi i një video dhe publikimi i saj në internet si dhe leximi i letrës me tekstin e B.it ndaj një udhëheqësi të ISIS-it, në të cilin ishte shënuar B.i, i akuzuari B.L. ka qenë ai i cili është deklaruar se do ta lexonin një letër në të cilën kishin shënuar “Betohemi mësuesit tonë, luftëtarit (të fesë) Ebi Bekri tani ALHusejniELKurejshiEL Bagdati për dëgjueshmëri dhe zbatimin e urdhrave në raste të vështira deri në sakrificë në raste të vështira dhe të lehta dhe nga varësit e tij për ne dhe nga të gjithë ata që rekomandojnë dhe kanë autoritet për urdhra, ndërkohë do të jem (i përpiktë ose i saktë sipas shariatit, Ligjit të Allahut) në fjalë nëse është nevoja dhe në rast të pafajësisë në atë që nga Allahu i madhëruar na vjen argumenti për këtë që po deklarojë dëshmitar e kam Allahun e madhëruar”.

Të akuzuarit natën kritike nuk kishin shkuar për t’u shëtitur, për të ngrënë syfyer dhe për faljen e namazit të natës, siç ata pretendojnë, sepse ata me vete kishin armë, uniforma, maska dhe flamurin e ISIS-it, dhe kishin tentuar që mos të vërehen nga askush dhe posa janë vërejtur nga roja ikin nga vendi i ngjarjes, për të fshehur veprën penale për të cilën kishin tentuar ta kryejnë, i hedhin çantat dhe sendet tjera në mbeturina, sepse të gjithë të akuzuarit kanë pranuar se kanë shkuar natën kritike tek liqeni i Badovcit, kur disa prej tyre kishin thënë se ka qenë veprim i gabuar.

Nuk është kontestuese se natën kritike të akuzuarit B. dhe E.L., kishin ardhur nga Mitrovica në Prishtinë, me veturë të tipit Golf II, rrugës për në ..., e kanë marrë edhe të akuzuarin G.H.n, kurse i akuzuari M.H., së bashku me B.I., i cili gjendet në arrati, kishin huazuar një veturë të tipit “Pasar” në kompaninë “E Petrol” vetëm për dy ditë dhe kishin ardhur nga Istogu në Prishtinë, rrugës kishin blerë pesë hamburgera, ishin takuar që të gjithë të Liqeni i Badovcit, sipas marrëveshjes paraprahe.

Se nuk është kontestuese se të akuzuarit natën kritike janë takuar të Liqeni i Badovcit, i cili fakt është vërtetuar nga të akuzuarit (përveç të akuzuarit G.H.), por edhe nga roja e liqenit M.V., i cili ka deklaruar se derisa ka qenë në vendin e punës si roje e liqenit ka vërejtur një veturë Golf 2, me ngjyrë të kuqe dhe disa persona të cilët e ndërronin vendin e tyre dhe pasi u janë dukur të dyshimte u ishte vënë pas. Kur është ofruar te vetura Golf ka takuar E.L.n dhe duke kontrolluar veturën ka vërejtur një qante me uniforma ushtarake, maska, dorëza dhe një flamur me shkronja arabe. Kurse i akuzuari M.H. ka deklaruar se B.in e ka bashkëfshatar, se ai ka kërkuar ta dërgonte në Prishtinë, pikërisht te Liqeni i Badovcit, me arsyetimin se kishte për ta takuar dikë, ku dhe e kanë takuar B.n të cilin e ka njohur edhe M. se ishin takuar disa herë në Mitrovicë, ndërsa arsyen e shkuarjes te liqeni, e arsyetuan se kishin për ta falur namazin e natës dhe për të ngrënë syfyri pasi ishte ramazan. Ndërsa i akuzuari G.H. ka pretenduar se nuk ka qenë natën kritike në vendin e ngjarjes, i cili pretendim është i pa bazuar dhe në kundërshtim të plotë me dëshminë e të akuzuarve B., E. dhe M. të cilët

kanë pranuar faktin se kanë qenë te Liqeni i Badovcit, për të ngrënë syfyri dhe për tu falur në natyrë të shoqëruar edhe nga G.H.. I akuzuari B.L. ka vërtetuar faktin se nga Mitrovica ka ardhur në Prishtinë, me gruan dhe fëmijët dhe djalin e axhës E.in dhe kanë shkuar te Liqeni i Badovcit, ku edhe janë arrestuar nga policia por fillimisht roja e liqenit i ka ndaluar të akuzuarin E. duke ia kontrolluar veturën dhe çantën që ishte në veturë. Nga mbrojtja e të akuzuarit E. është vërtetuar qëllimi i takimit të akuzuarve te liqeni, e që ka qenë leximi i letrës-B.it ndaj udhëheqësit Al Bagdati, e që ky i akuzuar ka deklaruar se B. ju ka thënë se së pari do të hanin syfyri dhe më pas do ta lexonin letrën me B. dhe B. do ta incizonte me telefon dhe do ta shpërndante në internet, se i kanë pasur me vete edhe uniformat, maskën dhe flamurin, kjo rrethanë është vërtetuar edhe me provat materiale që janë gjetur në vendin e ngjarjes, të cekura më lartë.

Se nuk është kontestuese, se i akuzuari B., ka qenë i pajisur me pushkë automatike, e kjo është vërtetuar nga i akuzuari E. i cili ka deklaruar se B. nga bagazhi i veturës te liqeni ka marrë një çantë dhe ka vazhduar buzë liqenit. I akuzuari M. ka theksuar se kur e ka mbajtur në dorë çantën ka qenë e rëndë dhe e ka pyetur çfarë ka në të, B. i ka treguar se ishte një kallash, kjo u vërtetua edhe nga provat tjera materiale të gjetura në vendin e ngjarjes, ku në mbeturina është gjetur arma automatike A-47me bajonetë, 32 fishek dhe 5 karikator, të cilën e kishin hedhur, se nga i akuzuari M.H. është vërtetuar se çantën e ka gjuajtur nga vetura e tij në mbeturina, kur e ka kuptuar se në te ishte arma dhe nuk ka dashtë ta marr me vete barrën e sajë, e që sipas mbrojtësit tij ka hequr vullnetarisht dorë nga kryerja e veprës penale me hedhjen e çantës.

Nuk është kontestuese se i akuzuari F.M., natën kritike i ka transportuar të akuzuarit G.H.n dhe B.I., për tu arratisur nga vendi i ngjarjes, edhe pse i njëjti ishte i licencuar si taksist, për shërbimet e kryera taksisti paguhet, kurse në rastin konkret këtë shërbim e kishte bërë pa pagesë, se sipas tij të akuzuarit G. dhe B. ishin vëllezër të tij, ai të gjithë myslimanët i quan vëllezër, i cili fakt vërtetohet dhe nga thirrja telefonike të cilën ia kishte bërë G.H., duke

i thënë “hajde merrem “, kurse i akuzuari M. ishte përgjigjur “u bë” që do të thotë se kanë pasur një marrëveshje paraprake për transportimin e tyre.

Se të gjitha këto vërtetohen edhe nga bastisjet e bëra në shtëpinë e të akuzuarve, ku janë sekuestruar kompjuterë të tyre, libra të ndryshme fetare, CD-e janë marrë fotot e tyre nga kompjuterët, ku shihet i akuzuari M. H. i veshur me uniformë ushtarake me armë të gjata në krah, me disa persona dhe me shenjën e organizatës ISIS, kurse i akuzuari G., gjithashtu shihet i veshur me uniformën e ISIS-it dhe i armatosur me granata dore të vendosura në trup me thikë dhe me armë zjarri, i shoqëruar edhe me të akuzuarin B.I., kurse i akuzuari B.L., ishte i fotografuar me gishtin e ngritur lartë dhe kapelë në kokë, e cila kapelë është gjetur në vendin e ngjarjes, e cila provë vërteton se i akuzuari ka qenë në vendin e ngjarjes dhe ka pasur edhe flamurin e ISIS-it, kurse nga kompjuteri i të akuzuarit E.L., vërtetohet se ai ka përdorur nofkën Ebu Talha, kurse me personin me të cilin ka komunikuar në rrjet social e ka përdor nofkën Ebu Muntisir, ku janë gjetur edhe disa foto të pjesëtarëve të organizatës ISIS si dhe flamuri i asaj organizate. I akuzuari G.H. dhe B.I., për të cilin është veçuar procedura që të dy kanë qenë pjesëmarrës të luftës në Siri, kurse fotot e flamurit ISIS dhe të organizatës terroriste, janë edhe një provë se ata përkrahin ideologjinë e tyre dhe këtë kanë tentuar të shpërndajnë përmes rrjetit social edhe tek personat e pa përcaktuar, sepse në kompjuterat e tyre janë gjetur dhe janë ruajtur ato dëshmi.

Nga të gjitha këto vërtetohet se të akuzuarit kanë vepruar në bashkëkryerje, sepse B.L. dhe G.H., paraprakisht ishin marrë vesh për tu takuar në vendin e caktuar, të pajisur me armë automatike dhe mjetet tjera, si uniforma ushtarake flamur, maska, dorëza, duke bashkëpunuar edhe me të akuzuarit tjerë, që nënkupton se kishin tentuar ta kryejnë veprën penale për të cilën janë shpallur fajtorë.

Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vepruar kur nuk ua ka falur besimin mbrojtjes se të akuzuarve, të cilët kanë theksuar se arsyeja e shkuarjes te liqeni ka qenë falja e namazit dhe ngrënia e syfyrit, por që këto veprime nuk do të duhej të ishin të përcjellë me armë uniforma, maska dhe flamura të ISIS-it, shkuarja në mënyrë të fshehte pa u vërejtur nga askush, se cila ishte dmth e faljes se namazit dhe ngrënies se syfyrit, mu në mes të natës në një vend malor, që nuk përketet as me kohën kur falet namazi dhe kur kryhet syfyri sipas orarit të ramazanit.

Kurse pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve se dëshmia e dhënë në polici dhe prokurori e B.I., i cili gjendej në arrati, për të cilin është veçuar procedura penale, është provë e pa pranueshme nuk qëndrojnë, se me propozimin e Prokurorisë speciale, me të cilin propozim janë pajtuar palët tjera në procedurë, kjo dëshmi është administruar si provë, konform dispozitave të procedurës penale, por kjo nuk ka qenë provë e vetme në këtë çështje penalo-juridike.

Sipas vlerësimit kësaj gjykate, të akuzuarit B.L., G.H., M.H., E.L. bashkë me të akuzuarin B.I. që gjendet në arrati, sipas marrëveshjes paraprake, natën kritike janë takuar të diga e Liqenit të Badovcit, të pajisur me pushkë automatike, bajonetë, 5 karikatorë dhe 32 fishekë, si dhe me uniforma ushtarake, maska për fytyrë, dorëza dhe flamurin e organizatës terroriste të ISIS-it, e që kanë pasur që ta lexojnë letrën, në shenjë të B.it ndaj udhëheqësit të organizatës terroriste ISIS, Abu Baker-al Bagdati, këtë ta incizojnë në video dhe ta publikojnë në internet për të dëshmuar shtrirjen e ISIS-it në Republikën e Kosovës, të shpërndajnë mesazhe për publikun, me qëllim të shtytjes se personave të pa përcaktuar që të kryejnë akte terroriste, të cilën video nuk kanë arritur që të incizojnë dhe ta publikojnë, për shkak të arrestimit të tyre nga ana e policisë, kurse i akuzuari F.M. pasi që të akuzuarit kanë

ikur nga vendi i ngjarjes për mos mu kap nga policia, i ka transportuar të akuzuarit G. dhe B. deri në shtëpitë e tyre pa pagesë, me çka është vërtetuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pretendon se me aktgjykimin e ankimuar është shkelur ligji penal në dobi të akuzuarve, kur gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit B.L., G.H., M.H. dhe E.L., i ka shpallur fajtorë për veprën penale shtytje në kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, kurse të akuzuarin F.M. për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale shtytje për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së, duke pasur parasysh se qëllimi i të akuzuarve ka qenë B. ndaj udhëheqjes së organizatës terroriste ISIS, kurse kualifikimi juridik nuk mund të bazohet vetëm në qëllimin për incizimin e videos dhe publikimin e saj në internet dhe të cilësohet vetëm si shtytje për kryerjen e veprave terroriste, sepse veprimet e të akuzuarve kanë pasur për qëllim pasoja më të rënda të mundshme për Republikën e Kosovës, e kjo është dhënia e B. ndaj udhëheqësit të organizatës ISIS dhe shprehia e gatishmërisë për zbatimin e urdhrave, ku secili prej të akuzuarve është pajtuar dhe ka treguar gatishmëri

për kryerjen e akteve terroriste, sipas prokurorisë qëllimi i të akuzuarve nuk ka qenë shtytja e personave tjerë për kryerjen e veprave terroriste, por kryerja direkte e akteve terroriste nga ana e të akuzuarve, për çka, edhe ata donin të betoheshin publikisht për zbatimin e urdhrave të tij. Prokuroria konsideron se me veprimet e të akuzuarve janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe Sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 dhe me nenin 145 dhe 135 par.1 nën par 1.7 të KPRK-së. Prokuroria konsideron se kualifikimi juridik i veprës penale ndaj të akuzuarit F.M., ndihmë në kryerjen e veprës penale shtytje për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së, është i paqëndrueshëm.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejt ka zbatuar Ligjin Penal kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarve B.L., G.H., M.H. dhe E.L., ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale shtytje në kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, kurse në veprime të akuzuarit F.M., elementet e veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale shtytje për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së, andaj pretendimet e PSRK i konsideron si të pa bazuara.

Mbrojtësit e të akuzuarve në ankesa pretendojnë se duke pas parasysh se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, kemi të bëjmë edhe me shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarve.

Gjithashtu, kjo gjykatë vlerëson se, edhe pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve B.L., G.H., M.H. dhe E.L., se gjykata e shkallës së parë, ka shkelur Ligjin Penal në dëm të akuzuarve, janë pretendime të pa bazuara, se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka zbatuar Ligjin Penal kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarve B.L., G.H., M.H. dhe E.L., ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale shtytje në kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, kurse në veprime të akuzuarit F.M., elementet e veprës penale ndihmë në shtytje për kryerjen e veprave terroriste në tentativë nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarve, sipas pretendimeve të mbrojtësve të akuzuarve për shkak se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën ata janë shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë, si dhe nuk qëndrojnë pretendimet e Prokurorisë Speciale, se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë elementët e veprës penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe të sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.4 lidhur me par.1 e që lidhet me nenin 31 të KPRK e lidhur me nenin 145 dhe 135 par.1 nën.par 1.7 të KPRK.

Prokuroria Speciale konsideron se dënimet ndaj të akuzuarve janë shumë të ulëta, duke pasur parasysh shqetësimet e qytetarëve të shkakuar nga veprimet e të akuzuarve tek Liqeni Badoc, rrezikshmërinë shoqërore të veprave terroriste, se veprat e tilla janë në rritje e sipër, me pasoja shkatërruese për njerëz dhe sistemin Juridik dhe kushtetues së Republikës së Kosovës.

Mbrojtësit e të akuzuarve B.L., G.H., M.H. dhe E.L., pretendojnë se duke pasur parasysh se me provat e administruara nuk është vërtetuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor, kanë kërkuar që të njëjtit të lirohen nga përgjegjësia penale, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit F.M. fare nuk e ka kontestuar aktgjykimin sa i përket vendimit mbi dënim, se sipas tij nuk ka provë konkrete e cila mund të qojë drejtë dënimin të cilin ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket ankesave të mbrojtësve të akuzuarve përkitazi me vendimet mbi dënim, kjo gjykatë vlerëson se, ankesat janë të pa bazuara.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të lartësisë se dënimin ka pasur parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, të cilat kanë ndikuar në lartësinë e dënimin, ku si rrethana lehtësuese i ka marrë sjelljet e të akuzuarve gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, se janë familjar, ndërsa si rrethana rënduese, intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe peshën e rëndë të kësaj veprë penale, gjykata e shkallës së parë, ka peshuar dhe individualizuar dënimet për secilin të akuzuar veç e veç, duke pasur parasysh se përfshirja e të akuzuarve në kryerjen e veprës penale nuk ka qenë e njëjtë për nga intensiteti i veprimit, i ka peshuar këto rrethana dhe duke vepruar në interes të zbatimit të duhur të drejtësisë ka përshtatur dënimet për çdo të akuzuar, konform dispozitave ligjore. Mbrojtësit të akuzuarve B.L., M.H. dhe E.L. në ankesa nuk kanë cekur ndonjë rrethanë për uljen e dënimin, e të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë, kurse mbrojtësi i të akuzuarit, G.H. ka cekur se dënimi është i lartë në raport me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari. Rrethanat që i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, për gjithë të akuzuarit i aprovon edhe kjo, andaj, kjo gjykatë vlerëson se dënimet e shqiptuara janë në funksion të parandalimit të kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimin i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga çka u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.435/2017, më 24.10.2017

Anëtarët e kolegjit:

1. Have Haliti _____

2. Mejreme Memaj _____